



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.152

9 nëntor

2009

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 169 datë 22.10.2009	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar	6871
Vendim i KM nr.982, datë 30.9.2009	Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës Vuno-Metoq	6873
Vendim i KM nr.983, datë 30.9.2009	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Terpan, të qarkut të Beratit	6876
Vendim i ERE nr.70, datë 12.10.2009	Për fillimin e procedurave për miratimin e planit të investimeve të OSSH sh.a. për vitin 2009-2010	6877
Vendim i ERE nr.71, datë 12.10.2009	Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për vitin 2010	6877
Vendim i ERE nr.72, datë 12.10.2009	Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për vitin 2010	6878
Vendim i ERE nr.73, datë 12.10.2009	Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për vitin 2010	6878
Vendim i ERE nr.74, datë 12.10.2009	Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike nga OSSH sh.a. për vitin 2010	6879

Vendim i ERE nr.75, datë 12.10.2009	Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike nga OSSH sh.a. për konsumatorët tariforë	6879
Vendim i ERE nr.76, datë 15.10.2009	Për mos miratimin e kontratave të negociuara nga shoqëria OSSH sha me shoqëritë Rudnap Group ad dhe Energy Financing Team Ag	6880
Vendim i ERE nr.77, datë 16.10.2009	Për mosmiratimin e “Raportit të auditimit të humbjeve” të OSSH sh.a. për vitin 2008	6880
Vendim i KKRT nr.879, datë 28.9.2009	Për dhënie licence për radion vendore private “Radio Vlora” sh.p.k	6881
Vendim i KKRT nr.880, datë 28.9.2009	Për dhënie licence për radion vendore private “Radio 4+” ...	6881
Vendim i KKRT nr.881, datë 28.9.2009	Për dhënie licence për radion vendore private “Radio Nostalgjia”	6882
Kërkesë e MPPTT nr.4518/2, datë 7.10.2009	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të përdorura, Korçë.....	6882

LIGJ
Nr.10 169, datë 22.10.2009

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 9482, DATË 3.4.2006 “PËR
LEGALIZIMIN, URBANIZIMIN DHE INTEGRIMIN E NDËRTIMEVE PA LEJE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Neni 1

Pas nenit 17 shtohet neni 17/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 17/1

Mënyra e pagesës së parcelës ndërtimore të ndërtimit pa leje

1. Pagesa e vlerës së parcelës ndërtimore të ndërtimit pa leje, në proces legalizimi, bëhet:
 - a) në lekë, në vlerë të plotë monetare;
 - b) me bono privatizimi, në përputhje me dispozitat e neneve 19, 20 e 21 të këtij ligji.
2. Bonot e privatizimit, të përfituara nga ish të përndjekurit politikë dhe nga subjektet e tjera gjatë procesit të privatizimit të pronës shtetërore, kanë të njëjtin trajtim me bonot e tjera të privatizimit.
3. Taksat, tatimet dhe detyrimet e tjera financiare, që lidhen me kalimin e së drejtës së pronësisë, bëhen vetëm në lekë.”.

Neni 2

Në nenin 19, në fund të shkronjës “dh” shtohen fjalët “dhe, deri në 50 për qind të vlerës, pagesa mund të kryhet me bono privatizimi.”.

Neni 3

Në nenin 20, në fund të shkronjës “ç” shtohen fjalët “dhe, deri në 50 për qind të vlerës, pagesa mund të kryhet me bono privatizimi.”.

Neni 4

Në nenin 21, në fund të shkronjës “ç” shtohen fjalët “dhe, deri në 50 për qind të vlerës, pagesa mund të kryhet me bono privatizimi.”.

Neni 5

Në nenin 22 paragrafi i parë, pas fjalëve “zbatohen të njëjtat tarifa” shtohen fjalët “dhe mënyra pagese”.

Neni 6

1. Në nenin 27, pas shkronjës “ë” shtohet shkronja “f” me këtë përmbajtje:

“f) kërkesë e subjektit për mënyrën e pagesës së parcelës ndërtimore të ndërtimit pa leje, në përputhje, përkatësisht, me nenet 19, 20 ose 21 të këtij ligji.”.

Neni 7

Në nenin 32, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Të ardhurat e arkëtuara nga transferimi i pronësisë së parcelave ndërtimore transferohen në Buxhetin e Shtetit për Agjencinë e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si fond kompensimi financiar, sipas parashikimeve të ligjit nr.9235, datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar.”.

Neni 8

Dispozita kalimtare

1. Personat, të cilët i kanë kryer pagesat për parcelat ndërtimore të ndërtimit pa leje përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, përfitojnë lehtësitë e parashikuara në këtë ligj.

2. Për të përfituar nga e drejta e pagesës me bono privatizimi për pjesën e mbetur të detyrimit apo për rikthimin e shumave të paguara në lekë, në këmbim të dorëzimit të bonove të privatizimit, personat duhet të paraqesin kërkesë, me shkrim, pranë ALUIZNI-it brenda 3 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

3. Procedurat dhe afatet e rimbursimit rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 9

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6320, datë 5.11.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

VENDIM
Nr.982, datë 30.9.2009

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS VUNO-
METOQ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrugës Vuno-Metoq.
 2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 4653 (katër mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e tre) m², tokë/arë, me vlerë 2 107 343 (dy milionë e njëqind e shtatë mijë e treqind e dyzet e tre) lekë, për sipërfaqen 267 (dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë) m², tokë/truall, me vlerë 418 442 (katërqind e tetëmbëdhjetë mijë e katërqind e dyzet e dy) lekë, për kultura, drufrutorë, me vlerë 576 982 (pesëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy) lekë, për objekte, me vlerë 1 380 464 (një milion e treqind e tetëdhjetë mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi 4 483 231 (katër milionë e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind e tridhjetë e një) lekë.
 4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 1 104 000 (një milion e njëqind e katër mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.
 5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, 4 483 231 (katër milionë e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind e tridhjetë e një) lekë, të përballohet nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”.
 6. Shpronësimi të fillojë më 1.10.2009 dhe të përfundojë më 1.1.2010.
 7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të bëjë likuidimin e pronarëve, brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi.
 8. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
DREJTORIA JURIDIKE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE
LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR VUNO-METOQ
Fshati Qeparo

Nr.	Emri	Atësia	Mbietmri	Zona kad.	Nr. pas.	Lloji i Pasurisë										Sip. objekti m ²	Shënime		
						Toke arë (Pentore)						Truall		Kult.druf				Objekte	
						Sip. m ²	Çmimi lek/m ²	Vlera (Lekë)	Sip. m ²	Çmimi lek/m ²	Vlera (Lekë)	Vlera (Lekë)	Sip. m ²	Vlera (Lekë)	Lloji			Vlera (Lekë)	
1	Leonidha	Milto	Polo	3095	110/1	59	452.9	26721.1				93116		119837.1	K.Zvrpp				
2	Kozma		Gjini	3095	110/2	253	452.9	114583.7						114583.7	K.Zvrpp				
3	Peli	Dhime	Zaho	3095	110/3	180	452.9	81522				84684		166206	K.Zvrpp				
4	Dhose	Nestur	Polo	3095	110/4	122	452.9	55253.8						55253.8	K.Zvrpp				
5	Veniamin	Petro	Xhuveti	3095	110/5	89	452.9	40308.1						40308.1	K.Zvrpp				
6	Elpo	Vjero	Vongli	3095	111/1	145	452.9	65670.5				88972		154642.5	K.Zvrpp				
7	Arsen	Irakli	Todhri	3095	111/2	126	452.9	57065.4						57065.4	K.Zvrpp				
8	Llambro	Aristidh	Kokedhima	3095	111/4	56	452.9	25362.4						25362.4	K.Zvrpp				
9	Arianthi	Gjike	Leka	3095	115/2	117	452.9	52989.3						52989.3	K.Zvrpp				
10	Bekim		Pasha	3095	116/1	167	452.9	75634.3				48024		123658.3	K.Zvrpp				
11	Aristidh	Mihal	Kondi	3095	120/3	111	452.9	50271.9						50271.9	K.Zvrpp				
12	Andrea	Sillo	Guma	3095	121/1	73	452.9	33061.7						33061.7	K.Zvrpp				
13	Arian	Andon	Thanasi	3095	121/3	75	452.9	33967.5						33967.5	K.Zvrpp				
14	Shulla	Nestur	Vongli	3095	121/5	41	452.9	18568.9						18568.9	K.Zvrpp				
15	Dhimitraq	Thanas	Kokedhima	3095	125/5/3	13	452.9	5887.7						5887.7	K.Zvrpp				
16	Aleks	Thanas	Kokedhima	3095	125/5/4	29	452.9	13134.1						13134.1	K.Zvrpp				
17	Mico	Kico	Sava	3095	125/6/1	65	452.9	29438.5						29438.5	K.Zvrpp				
18	Pano	Kico	Sava	3095	125/6/2	100	452.9	45290						45290	K.Zvrpp				
19	Kico	Mico	Sava	3095	125/6/3	90	452.9	40761						40761	K.Zvrpp				
20	Theodhori	Taso	Sava	3095	125/2	20	452.9	9058						9058	K.Zvrpp				
21	Katina	Cino	Baci	3095	125/1	102	452.9	46195.8						46195.8	K.Zvrpp				
22	Timo	Thanas	Qesari	3095	127/66	83	452.9	37590.7						37590.7	K.Zvrpp				
23	Virginia		Zhupa	3095	138/45	78	452.9	35326.2						35326.2	K.Zvrpp				
24	Vasil	Llavidh	Gjikondi	3095	138/46	521	452.9	235960.9				100664		336624.9	K.Zvrpp				
25	Stavrulla	Spiro	Lani	3095	138/48	334	452.9	151268.6				48024		199292.6	K.Zvrpp				

VENDIM
Nr.983, datë 30.9.2009

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS TERPAN, TË QARKUT TË BERATIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Terpan të qarkut të Beratit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Terpan të qarkut të Beratit, miratuar me vendimin nr.926, datë 2.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Terpan, të qarkut të Beratit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Terpan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Terpan

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1	Prona që përdoren për realizimin e programeve administrative.	Në pronësi
2-13	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
14-15	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
16-25	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në zhvillimin ekonomik.	Në pronësi
26-40	Varrezat publike	Në pronësi
41-60	Infrastrukturë (Rrugë vendore)	Në pronësi
61-74	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
100-133,135-137,140-142,144-146,148-151,153-163	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
134,138,139,143,147,152	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta).	Në pronësi

VENDIM
Nr.70, datë 12.10.2009

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE TË
OSSH SHA PËR VITIN 2009-2010

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.10.2009, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OSSH sh.a. për miratimin e planit të investimeve për vitin 2009-2010,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e planit të investimeve për vitin 2009-2010.
 2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSSH sh.a. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.71, datë 12.10.2009

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA KESH SHA PËR VITIN 2010

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20 dhe 21 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.77, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.10.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a. për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për vitin 2010.
 2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
- Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.72, datë 12.10.2009

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR FURNIZUESIN PUBLIK ME SHUMICË PËR VITIN 2010**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 20, 21 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.78, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.10.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e çmimeve të energjisë elektrike për aktivitetin e furnizimit publik me shumicë për vitin 2010.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.73, datë 12.10.2009

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË TRANSMETIMIT
TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA OST SHA PËR VITIN 2010**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20 dhe 21 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.59, datë 29.12.2005 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.10.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e OST sh.a. për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për OST sh.a. për vitin 2010,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OSSH sh.a. për vitin 2010.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSSH sh.a. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.74, datë 12.10.2009

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHPËRNDARJES
SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA OSSH SHA PËR VITIN 2010**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20 dhe 21 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.79, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.10.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e OSSH sh.a. për përcaktimin e tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike për OSSH sh.a. për vitin 2010,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike për OSSH sh.a. për vitin 2010.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSSH sh.a. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.75, datë 12.10.2009

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË FURNIZIMIT
PUBLIK ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA OSSH SHA PËR
KONSUMATORËT TARIFORË**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20 dhe 21 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.80, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me pakicë së energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 12.10.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e OSSH sh.a. për përcaktimin e tarifës së furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike nga OSSH sh.a. për konsumatorët tariforë për vitin 2010,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike nga OSSH sh.a. për konsumatorët tariforë për vitin 2010.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSSH sh.a. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.76, datë 15.10.2009

**PËR MOS MIRATIMIN E KONTRATAVE TË NEGOCIUARA NGA SHOQËRIA OSSH SHA
ME SHOQËRITË RUDNAP GROUP AD DHE ENERGY FINANCING TEAM AG**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 2.10 të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.42, datë 25.5.2009 “Rregullat dhe procedurat standarde të prokurimit të energjisë elektrike nga OSSH sh.a.”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.10.2009, mbasi shqyrtoi kërkesën e OSSH sh.a., si dhe relacionet e drejtorive teknike në ERE,

Konstatoi se:

Pas shqyrtimit të procedurës së prokurimit të zhvilluar nga shoqëria OSSH sh.a., si dhe duke iu referuar rregullave dhe procedurave standarde të prokurimit të energjisë elektrike nga OSSH sh.a., në procesin e negocimit nuk është realizuar kushti që çmimi i pranuar në kontratë të jetë më i ulët se çmimi i ofruar në tenderin e anuluar përpara se të fillojë procedura e negocimit.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Mosmiratimin e kontratave të negociuara nga shoqëria OSSH sh.a. me shoqëritë RUDNAP GROUP AD dhe Energy Financing Team AG.

2. Ngarkohet OSSH sh.a. të marrë masa për sigurimin e energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve për vitin 2010 sipas rregullave dhe procedurave standarde të prokurimit të energjisë elektrike nga OSSH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.77, datë 16.10.2009

**PËR MOSMIRATIMIN E “RAPORTIT TË AUDITIMIT TË HUMBJEVE” TË OSSH SHA PËR
VITIN 2008**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 4.5, paragrafi i fundit, i deklaratës rregullatore të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.12, datë 3.3.2009, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 16.10.2009, pasi shqyrtoi “Raportin e auditimit të humbjeve” të OSSH sh.a. për vitin 2008 të paraqitur nga shoqëria OSSH sh.a., dhe relacionin e drejtorive teknike në ERE,

Konstatoi se:

Bazuar në “Raportin e auditimit të humbjeve” të OSSH sh.a për vitin 2008, dokumentet mbështetëse të paraqitura, si dhe në deklaratimet gjatë seancës dëgjimore “Raportin e auditimit të humbjeve” të OSSH sh.a. për vitin 2008, nuk vërteton nivelin e pretenduar prej tij për humbjet e përgjithshme në sistemin e shpërndarjes për vitin 2008.

Për gjithë sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të mosmiratojë “Raportin e auditimit të humbjeve” të OSSH sh.a. për vitin 2008.
 2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OSSH sh.a. për këtë vendim.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.879, datë 28.9.2009

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION VENDORE PRIVATE “RADIO VLORA”
SUBJEKTIT: “RADIO VLORA” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, si dhe frekuencave dhe kanaleve të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimit nr.855, datë 15.5.2009, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Ti japë subjektit “RADIO VLORA” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analoge për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin e Vlorës.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Alban Karapici

VENDIM
Nr.880, datë 28.9.2009

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION VENDORE PRIVATE “RADIO 4+”
SUBJEKTIT: “MISHEL” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, si dhe frekuencave dhe kanaleve të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimit nr.855, datë 15.5.2009, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Ti japë subjektit “MISHEL” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analoge për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethin e Lushnjës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Alban Karapici

VENDIM
Nr.881, datë 28.9.2009

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION VENDORE PRIVATE “RADIO NOSTALGJIA”
SUBJEKTIT: “NOSTALGJIA” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, si dhe frekuencave dhe kanaleve të lira të shpallura në mënyrë publike në mbështetje të vendimit nr.855, datë 15.5.2009, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Ti japë subjektit “NOSTALGJIA” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analoge për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qarqet Tiranë-Durrës-Fier-Vlorë.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Alban Karapici

KËRKESË
Nr.4518/2, datë 7.10.2009

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i impiantit të trajtimit të ujërave të përdorura, Korçë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Shoqëria Aksionare Ujësjiellës-Kanalizime Korçë. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët, sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 4 345 000 (katër milionë e treqind e dyzet e pesë mijë) lekë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
 DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
 DREJTORIA JURIDIKE
 SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I
 KOLEKTORIT TË GRUMBULLIMIT TË UJËRAVE TË PËRDORURA
 PËRGJATË SUPËRSTRADËS KORÇË-KAPSHITCË

Nr.	Emri, mbiemri i pronarit	Nr. i pasurisë	Z.Kadastrale	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera totale lekë	Shënime
1	Vasil Panariti	8/251	8561	truall	166.2	10 000	1 662 000	Konfirmim ZRPP
2	Nikolla Ligor Çeço	8/50	8561	truall	268.3	10 000	2 683 000	Konfirmim ZRPP
	Totali lekë						4543000	

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori). Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 6.11.2009
Doli nga shtypi më 9.11.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 16 lekë